

PERMBLEDHJE E RAPORTIT TE VLERESIMIT
TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER AKTIVITETIN

***Prodhimi i mobiljeve ID 11.1 Prodhim i mobiljeve,
nqs nuk janë përmendur diku tjetër në këtë
Shtojcë. Kapaciteti i prodhimit më i madh se 1000
m³ në vit.***

**Veprimtari tjetra që përfshijnë përdorimin e
solventëve ID 7.12 l. Veprimtaritë e lyerjes/veshjes
të aplikuara në sipërfaqe druri *Të gjitha instalimet.***

Korel&CO

Elbasan Bradashesh KUSARTH Rruga Kadri Hoxha , Fshati Kusarth

NUIS: K73324202T

Tel: 0695395944

E-Mail: magazina@korel.al Telefon: 0692069107



Hyrje

Shoqeria "KOREL&CO" sh.p.k. është themeluar në 24.09.2007 me administrator Dritan Marku .

Veprimtaria e saj është në fushën e Prodhimit dhe perpunimit të materialeve prej druri, alumini, plastike, xham etj. Te bleje apo te zoteroje në ndonjë mënyrë tjetër, të importojë, magazinonjë, ruajë, eksportojë apo tregtojë me shumicë e pakicë mallra të ndryshme, përfshirë ato ushqimore, bujqësore e blegtoriale, si dhe çdo lloj malli tjetër. Shoqeria ka gjithashtu të drejtë të ketë pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja si dhe të ndërmarrë çdo akt financiar, ekonomik apo tregtar lidhur me objektin kryesor të saj dhe që gjykohej i nevojshëm apo i leverdisshëm për të. Te paketojë mallra dhe lende të importuara. Te prodhojë, riparojë, importojë, blejë, shesë, eksportojë, lere me qera dhe në përgjithësi të tregtojë ose të merret me çdo lloj paisjesh, artikujsh, aparatash, makineri për fabrika, vegla, mallra, sende të çdo lloji të cilat mund të përdoren ose me të cilat mund të merret shoqëria me ndonjë nga objektet e saj. Te kryej konsullencë, këshillime financiare apo manaxhimi në lidhje çdo lloj pasurie të paluajtshme. Import-eksport në përputhje me qellimet e shoqërisë. Te ndërtojë, menaxhojë, konstruktojë, ndryshojë, 2 zmadhojë, riparojë, adaptojë, mobilojë çdo dyqan, magazine, zyra, apartamente, impiante, fabrika, të cilat do të konsiderohen nga shoqëria si të nevojshme për qellimet e biznesit të sajë.


I gjithë stafi i "KOREL&CO" SH.P.K. nga drejtori teknik, drejtori financiar, manaxheri i cilësisë dhe punonjësit e tjerë verifikojnë dhe ndjekin proceset që kanë ndikim mbi cilësinë e produktit. Nëpërmjet mjeteve të menaxhimit ajo ka aftësinë në mënyrë aktive të formimit në të ardhmen, duke identifikuar dhe implementuar tendencat në mënyrë fleksibile për tu përgjigjur kërkesave të tregut dhe të klientëve tanë. Qëndrueshmëria është një pjesë e madhe e zakonit tonë të punës dhe procedurave.

Vendodhja Zona e ushtrimit të aktivitetit karakterizohet nga zhvillime të shumta në karakterit industrial, ekonomik. Në këto zone kemi infrastrukture të ngritura e cila i shërben mirë funksionimit të aktivitetit por jo vetëm.

KOREL

Kordinata Gauss Kruger

Nr X	Y
1 4419526.80	4553362.16
2 4419566.70	4553373.74
3 4419580.75	4553254.29
4 4419548.26	4553247.84



▪ **INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR**

Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vleresojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Objektivat afatshkurter të VNM janë:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrën e duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë Teknikat më të mira të Disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogelimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundeson informimin e vendim-marrësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate të VNM janë:

- Siguron dhe mbrojt shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/dëmtimet e pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentet perberes të ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike të projektit
- Ndhomon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

Përshkrim i përmblendhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe dëmtimin e komponenteve të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit nga faktore të ndryshme, njerëzore dhe natyrore. Nder ligjet më kryesore në lidhje me këtë projekt, mund të përmendim:

- Ligji Nr. 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.
- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.
- Ligji Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Për menaxhimin e zhurmave”.
- Vendim Nr. 313, datë 09.05.2012 “Për rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis”.

- Vendim Nr. 686, date 29.07.2015 “Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.
- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore”.
- Udhezim Nr. 8, dt.27.11.2007 “Per nivelet kufi te zhurmave.

Shenim:

Bazuar ne Ligjet e mbrojtjes se mjedisit, ky aktivitet, perfshihet ne listat e aktiviteteve te cilat duhet te paisen me leje mjedisore te tipit B, por nuk listohet nder aktivitetet te cilat duhet ti nenshtrohen procedures se VNM Paraprake.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis, hartohet per te informuar publikun dhe institucionet e mbrojtjes se mjedisit mbi ndikimet ne mjedis te aktivitetit.

Proçesi teknologjik

Me poshte po paraqesim e gjithë fazat e proçesit teknologjik si dhe strukturen perkatese te subjektit per ushtrimin e ketij aktiviteti

Lëndët e para dhe materialet ndihmëse janë, derrasat e staxhionuara, pllaka melamine MFC, pllaka fibre MDF, rimeso, pllakë (clipboard), bojra për lyerje me bazë uji, bojra për lyerje me bazë solventi, solvente, llakra të ndryshme, pigmente te ndryshme, pëlhura (natyrale, sintetike, të përziera) stuko, llace, si dhe substanca ndihmëse që janë pjesë e bojrave.

PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Materialet drusore merren nga subjekte të licencuar dhe pas magazinimit të tyre në ambiente të brendshme. Proceset qe do kaloje ne disa faza: lenda e pare kalon ne procesin e prerjes ku priten sipas përmasave të caktuara më parë në varësi të gabariteve të mobiljeve që do prodhen. Pas procesit të prerjes kalojnë në makineritë plane për dhënien e formave të rregullta dhe të drejta gjeometrike si dhe në makineritë kalibruese. Pastaj kalojnë për frezim në frezat horizontale apo vertikale sipas llojit dhe formave për prodhim të mobiljeve të porositura më parë, kalojnë në procesin lëmimit dhe pastrimit te sipërfaqes(zmerilimit) në makineritë zumparo dhe me pas ne procesin e lyerjes dhe paketimit sipas pjeseve me qellim montimin e tyre. Kjo ne varesi te kerkeses se klientit.

Procesi i punes

Në realizimin e ketij aktiviteti, proçeset kryesore teknike janë: Prodhimi i mobiljeve që zhvillon subjekti, kryhet me proceset e sharrimit, frezimit, shpimit, zdrukthimit, gdhendjes, tomimit, dhe lyerje/veshje të drurit. Radha e punës parashikohet të jetë si më poshtë:

- 1) Kontrolli i sistemit të sigurisë;
- 2) Kontrolli i sistemit të mbrojtjes nga zjarrit;
- 3) Proceset e prerjes së drurit;
- 4) Proceset e frezimit,
- 5) Proceset e shpimit,

- 6) Proceset e zmerilimit
- 7) Proceset e tornimit,
- 8) Proceset e kujdesit ose trajtimit të drurit dhe lyerje/veshje të drurit
- 9) Menaxhim të mbetjeve te drurit

PAISJET

- 1- AGABBIANI GALAXY 105-Sharre automatike
- 2- IDM Makineri rimesimi
- 3- G/310 ITALPRESSE-Gershere hidraulike
- 4- BARBERAN PL45-D-Makineri rimesim kasash
- 5- DELLI VEDOVE-MAKINERI ZMERILIM KASASH
- 6- Qick wood-Makineri zmerilim fasaturash
- 7- CB-NV13-Makineri zmerilimi
- 8- ACIMAL-sharre shirit
- 9- SICAR BOOM 3200-Gonjaster
- 10- MARZANI MACCHINE-Prese
- 11- RECORD 100AL-Pantograf
- 12- OMEC F9-makineri prerje kasash
- 13- PAOLONI TT30- Gonjaster
- 14- STEFANI SOLUTION- Makineri presimi
- 15- MORBIDELLI 330NB- Freze elektronike
- 16- KABINE LYERJE(2 Cope)
- 17- MAKINERI TOPSET XL PER FORME KASASH DHE FASHATURASH
- 18- PRESE
- 19- PLAN PER CARJE DERRASASH PIRIN H40
- 20- GJENERATOR BRUNO
- 21- KOMPRESOR ATLAS COPCO
- 22- KOMPRESOR COTIPAIR BROOMWASE
- 23- SILLOZI
- 24- MAKINERI BLUM PER HAPJE MENTESHASH
- 25- MAKINERI PER PRERJE FASHATURASH

Infrastruktura

Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik Energjia qe do te perdoret do te jete energji elektrike e cila sigurohet nga rrjeti energjistik i zones nepermjet kontrates se lidhur me OSHEE.

Furnizimin me uje

Furnizimi me uje behet nga rrjeti i ujesjellesit te zones.

Rrjeti i Kanalizimeve. Shkarkimet e ujerave sanitare dhe reshjeve behen ne ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i

pranueshem. Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njerën prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe linjes teknologjike. Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky aktivitet do te vazhdoje te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Impakti ne mjedis dhe menaxhimi i tij

Ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin te cilat lidhen me produktet perfundimtare te prodhimit se bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre. Ndikimet e mundshme ne mjedis te lidhura me aktivitetin do te vleresohen ne disa elemente te mundshem te cilet jane:

Ndikimet ne ajer

Ndikimet ne peisazh

Ndikimet e zhurmave gjate punes

Ndikimet e ngurta

• **Shkarkimet ne ajer** Ndikime në shkarkimet në ajër nuk do te kete sepse nuk ka shkarkime të tjera të gazta si djegie karburantesh etj., nuk do të ketë nga ky aktivitet, për faktin se makinerite e linjes funksionojne me energji elektrike.

• **Ndikimi ne peisazh** Nuk ka ndikime në peisazh, sepse zona në të cilën ndodhet objekti, nuk do të ketë ndikime të pjesshme, gjatë periudhës së funksionimit. Peisazhi nuk do të ndryshojë, mbasi është në zonë për zhvillim biznese. Mbetjet e ngurta do të mblidhen përkohësisht në kazanët përkatës, në mënyrë që të jenë të gatshme për tu tërhequr nga Bashkia.

• **Ndikimet e zhurmave gjate punes** Dihet që gjatë funksionimit linjes se mobiljeve do të kemi rritje të nivelit të zhurmave por brenda normave te zonave rurale dhe orarit te percaktuar sipas ligjit shqiptar, si pasojë e funksionimit të makinerive te prodhimit të mobileris.

Mbetjet.

Te gjitha mbetjet qe dalin nga ky aktivitet jane te riciklueshme. Mbetjet metalike u jepen subjekteve te licensuara, ndersa mbetjet urbane evadohen nga ndermarja perkatese e bashkise ne incineratorin e bashksie qe ndodhet ne zonen industriale.

Ndotja e tokes

Ndotja e tokes si rezultat i rrjedhjeve te ndryshme gjate ngarkimit dhe shkarkimit te automjeteve apo ne rast te emergjencave te mundshme nga avarite ne sistem; Sistemi i transportimit dhe ngarkim-shkarkimit eshte i mbyllur dhe mundesite e derdhjeve ne mjedis te lendes gjate procesit nuk egzistojne. Sistemi i terminalit te shkarkimit eshte i shtruar me beton dhe si rrjedhoje nuk do te kemi ndotje te tokes, ne raste te derdhjes se lendes ne mjedis. Minimizimi i ndikimit ne mjedis lidhet me shkallen e trajnimit dhe ndergjegjesimit te punonjesve te kompanise per te mos lejuar furnizuesit apo çdo firme kontraktuese qe siguron furnizimin me lende te pare, te shkaktoje shkarkim te lendes se pare ne toke.

Automjetet dhe makinerite jane te kolauduara nga Qendra e Kontrollit Teknik te Automjeteve. Mundesia e ndotjes nga rrjedhjet eshte pothuajse zero. Automjeteve duhet tu kryhet pastrimi ne menyre periodike per te mos mbartuar papasterti te lendeve qe transportojne.

Përmbledhje e ndikimeve të mundshme negative në objektin ku realizohet aktiviteti

• Në Tokë

	<i>Ndikimi i mundshëm</i>	<i>Sqarim</i>
1	Shkarkimi i vajrave dhe lubrifikanteve nga mjetet e punës (avari teknike)	Bëhet fjalë për ndonjë rast të rrallë të rrjedhjes gjatë difekteve dhe çarjeve të tubave të instalimit dhe mjeteve të transportit

• Në Ajër

	<i>Ndikimi i mundshëm</i>	<i>Sqarim</i>
1	Shkarkimi i pluhurave	Mund të ketë vetëm në mjedis të brendshëm gjatë aktivitetit, por nuk ka emetime jashtë sepse funksionon impianti i pluhur kapjes. Sasia e gazrave është zero.
2	Emetimi i zhurmave	Vlerat standarte të emetimit të zhurmave janë brenda standarteve. Në mjediset e punës zhurmat ndjehen me shumë ndersa në mjediset e jashtme janë të papërfillshme sipas teknologjisë, kontroll teknik të instalimit.
3	Ngritja e grimcave të pluhurit	Gjatë punës dhe gjatë pastrimit të makinerive/pajisjeve, por që kapen nga sistemi i pluhur kapjes.

Vlerësimi i rëndësisë të ndikimeve në mjedis të aktivitetit

<i>Receptori i ndikimit</i>	<i>Shtrirje fizike madhësia</i>	<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Kthyeshmëria</i>	<i>Rëndësia si shumatorë e shtrirjes, kohëzgjatja dhe kthyeshmëria</i>	<i>Nevojat për masat zbutëse</i>
TOKA					
Shfrytëzimi i ambientit/territorit	Lokale	Përhershëm (objekt ekzistues)	Po	I pa rëndësishëm	mirëmbajtja e godinës, linjave dhe territorit përreth
Ndikim në gjenerimin e mbetjeve të ngurta urbane	Lokale	Gjatë gjithë periudhës së prodhimit	Po	I pa rëndësishëm	Vendosja e kontenerëve për grumbullimin e mbetjeve sipas llojit
BIODIVERSITETI					

Shqetësim i faunës së zonës	Lokale	Përkoshëm	Po	I pa rëndësishëm	Është zonë e varfer me gjallesa
Ujrat					
Shkarkimi i ujrave teknologjik	Lokale	I Përkoshëm	Po	I pa rëndësishëm	Nuk ka shkarkime te ujrave teknologjike. Nedersa Shkarkimi i ujrave sanitare do të bëhet në rrjetin e kanalizime të zonës
AJER					
Shkarkimi i gazrave nga motorrat që punojnë me lëndë djegëse fosile	Lokale	I përkoshëm	Po	I pa rëndësishëm	Kolaudimi dhe kontrolli i çlirimit të gazrave në skapamentot e makinerive
Emetimi i grimcave të pluhurit	Lokale	Vetem gjate punes te lendes se pare	Po	I pa rëndësishëm	Kapen nga sisetmi pluhur kapjes per cdo makineri e paisje

• **Permbeldhje e ndikimeve negative ne mjedis**

Sektori	Presionet mjedisore	Ndikimet	Llojet	Pershkrimi / masat lehtesuese
Cilesia e Ajrit	Emetimi i substancave ndotese (dioksid karboni CO, NOx, SOx) nga	I papefillshem Perdoret energji ektrike e paster nepemjet paneleve	Rajonal E perhershme E prapsueshme	Perqendrimi i ulet

	automjetet dhe gjate saldimeve			
Toka dhe ujrat nentokesore	Prania e ndotesve te mundshem ne toke dhe ujerat nentokesore.	Ambjenti nuk eshte i sistemuar dhe i shtruar me beton dhe nuk ka shkarkime te ujerave te ndotura sepse nukl perdiret uje per nevioja teknologjike	Lokale	Te gjitha zonat duhet te jene te shtruara dhe pajisur me sistem kanalizimesh. Mundesia e ndotjes se tokes dhe ujerave nentokesore nuk ekziston.
Shkarkimi i Ujrave te perdorura	Ndotja e ujrave sipërfaqesore si rrjedhoje e shkarkimeve te ujerave sipërfaqesore dhe sanitare	Ndotje e ujerave sipërfaqesore pritesë, nga shkarkimet e ujerave te shiut ose larjes se instalimeve dhe mjeteve. Uji eshte menduar te kaloje me pare ne nje grop dekantimi qe sherben edhe si kolektor kryesor i sheshit.	Lokale	Mirembajtja dhe pastrimi i sistemit te kanalizimeve te ujerave te ambjentit.
Zhurma	Emetimi i zhurmave nga procesi i punes.	Funksionimi do te kete ndikime ne ambjentin e punes, por nuk eshte shqetesim per objektet e tjera fqinje, megjithese kufizohet edhe me hapësira te lira.	Lokale E perhershme E prapsueshme	Nuk rekomandohen sepse vleresohen ne nivele te lejueshme. Rekomandohet qe punetoret te perdorin mjete mbrojtese per tu mbrojtur nga ndikimi i zhurmes.
Zonat Natyrore dhe te Ndjeshme	Ndikimi mbi habitatet e ndjeshme nga emetimet ne ajer.	Perqendrimet ne ajer e ndotesve do te jene ne perputhje me kufijte e percaktuar nga Direktiva e KE per mbrojtjen e mjedisit.	Rajonal E perhershme E prapsueshme	Menaxhimi i ujerave te perdorur dhe i mbetjeve te ngurta.


Peizazh	Modifikimi i karakteristikave peisazhore	Objekti eshte i rrethuar, kufizuar dhe i sistemuar	Rajonal E prapsueshme	Rekomandohet mbjellje e pemeve te larta perreth objektit, ne menyre qe te reduktohet impakti ne mjedis per shkak te demtitimit te peizazhit.
Trafiku	Rritja e trafikut rrugor	Furnizimi me lende te pare dhe shitja e produktit do te rrise numrin e kamioneve ne rrjetin rrugor, por ne nivele te uleta.	Lokale E perhershme E prapsueshme	Do te perdoren rruget ekzistuese dhe nuk do te hapen rruge te reja. Infrastruktura eshte ne pergjithesi e mire dhe objekti ndodhet ne afersi te rruges kryesore. Te kufizohet qarkullimi ne pikun e trafikut.
Social Ekonomik	Mundesi te reja punesimi	Gjate funksionimit te instalimeve jane te punesuar disa dhjetera punetore dhe specialist te mesem e te larte	Rajonal E perhershme E prapsueshme	Nje vleresim specifik mbi ndikimin social eshte planifikuar te kryhet per te vleresuar me detaje ndikimet pozitive dhe negative te finstalimeve mbi popullsine vendase.
Shendetit Publik	Ndikime ne cilesine e ajrit Zhurma e shkaktuar nga aktiviteti	Perqendrimet e ndotesve te emetuar jane shume te vogla dhe do te jene ne perputhje me gjendjen aktuale te cilesise se ajrit. Nuk parashikohet ndikim ne	Rajonal E perhershme E paprapsueshme	Nje vleresim specifik mbi ndikimin social eshte planifikuar te kryhet per te vleresuar me detaje ndikimet pozitive dhe negative te linjes mbi popullsine vendase. Ndikimet vleresohen

		shendetin e njerezve.		pozitive ne lidhje me zhvillimin e zones.
Ndikime te tjera	Ndikime ne mjedisin natyror dhe shendetesor.	Nepermjet procesit te prodhimit te makinerive e paisjeve,	Rajonal E perhershme	Subjekti te ushtroje aktivitetin brenda normave shqiptare te miratuar, duke u mbeshtetur nga institucionet e mbrojtjes se mjedisit per efektin pozitiv ekonomik-sosocial qe mbart.

MASAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV

<i>Rekomandime për zbutjen e ndikimeve</i>	
Toka	
Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave dhënë në relacion. Respektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
Erozioni	
Mbrojtja nga erozioni	Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e linjës së të prodhimit. Ndërtimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirëmbajtja e bazamentit ku janë të instaluar linja e prodhimit të mobiljeve.
Biodiversiteti	
Vegjetacioni Dëmtim potencial i vegjetacionit	Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidanëve të rinj, përgjatë rrugës që ben të mundur hyrjen për në objekt.
Fauna	
Shqetësim i specieve, dëmtim aksidental i tyre	Objekti është i rrethuar , mirëmbajtja dhe rikonstruktimi i tyre në rast dëmtimi. Në regjistrin kombëtarë të specieve të mbrojtura, kjo zonë është e përjashtuar dhe nuk karakterizohet nga specie të mbrojtura dhe nuk përbën shqetësim për habitatin.
Cilësia e ajrit	
Rritje e emetimeve të gazrave nga funksionimi i kaldajës për prodhim avulli dhe	Mjete me kolaudim optimal. Pjesë kembimi rezerve brenda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i mbetjeve të drurit dhe karburantit cilëso për

djegia e karburantit të automjeteve ngarkim-shkarkimit	makinat e transportit. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. Pastrimi periodik i linjës, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij.
Sistemi i kullimit	
Sistemi i kullimit	Mirembajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut, përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, bashkimi i tyre në një pusetë të përbashkët, ku më pas do të realizohet shkarkimi në kolektorin kryesorë të kanalizimeve të zonës
Mbetjet	
Shtim i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në objekt.	Vendosja e kontenerëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas llojeve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitim më të afërt të caktuar nga njësi vendore. Asgjësimi i mbetjeve nga kompani të licensuara. Rikuperim, Riciklim dhe Ripërdorim në maksimum i mbetjeve metalike.
Ujërat e Ndotura Urbane	Dekantim i ujrave të përdorura duke i deguar në vasken e dekantimit dhe më pas shkarkimi i tyre në kolektorin kryesor të zonës. Lidhja me sistemin e kanalizimeve të zonës. Minimizimi i konsumit të ujit.
Zhurmat	
Rritje e nivelit të zhurmave nga lëvizja e automjeteve	Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorim i linjës së prodhimit brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjatë orareve të përshtatshme.
Zjarri	
Mbrojtja nga zjarri	Godina dhe linjat e prodhimit kanë një strukturë rezistente ndaj zjarrit, bazamenti mbi të cilin janë instaluar linjat janë konstrukcion B/A, Beton Armë me rezistencë të lartë ndaj zjarrit. Linjat janë të mbrojtura nga zjarri dhe në linjat e prodhimit janë të instaluar sensorë të cilët i përcjellin informacion panelit të komandimit për temperaturën e secilës aparaturë, në rast zjarri linja e prodhimit stakohet automatikisht duke siguruar vetë linjen deri në ndërhyrjet nga organet kompetente. Shoqëria ka marrë licensën e mbrojtjes kundër zjarrit, sipas së cilës janë instaluar të gjitha aparaturat dhe pajisjet e nevojshme për mbrojtjen e instalimit dhe objektit nga rastet e mundshme të zjarreve.
Trafiku rrugor	
Trafiku Rrugor	Lëvizshmëria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do të



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 4935 Prot.

Tiranë, më 22.06 2017

Nr. identifikues 361

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. ERVIS MALAJ

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI


Lefter KOKA





MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISE DHE SUPERMARKETJES

LICENCË



LN-9472-04-2015 NUIS/NIPT: L51607502C

Subjekti: Ervis Malaj

Adresa: Durrës, Durrës, DURRES, Lagjia 7, rruga Hajdar Demiri, pallat 8-katësh, zona kadastrale 8512, nr pasurisë 5/192, kati i parë.

Kodi: III.2.A (1+2) Kod tjetër:

Data e lëshimit: 12/02/2016 Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

1. Ekspertizë mjedisore
2. Auditim mjedisor

Emërtimi përshkruar i veprimtarisë

Vlerësim i ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë



Nënshtkrimi i sportelit: JULIA TRAJA